**VENDIM**
**Nr. 493, datë 30.7.2021**

# PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VORË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE BËRXULL, TË PASURISË 303/1, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 1167

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "b", 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Vorë, për njësinë administrative Bërxull, të pasurisë 303/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 1167, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planrilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e arsimit.
2. Bashkisë Vorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Bashkia Vorë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETERORE**

**(Për inventarizimin e pronave të vecanta)**

**Bashkia Vorë/Njësia Admin.Bërxullë**

**Identifikoi: Adrian Subashi (Përgjegjës)**

**Supervizoi: Luan Pipero (Specialist )**

**Aprovoi : Gentian Picari (Kryetari I Bashkisë)**

**Fusha e përdorimit të Pronës: Arsim**

| Nr. rendor | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona kadastrale &Indeksi i Hartës | Nr.Pasurisë | Lloji i pronës | Emri i Pronës Adressa | Sip.totale e pronës (m2) | Nga sip: Totale ndërtese m2 | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/Enti me përgjegjësi Administrative | Institucioni/Enti përdorues statusi juridik i përdorimit | Të dhëna të tjera (Shënime të Vecanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 2 | 1167 K-34-88 215-c | 303/1 | Truall | Shkolla 9-vjecare Fshati Bërxullë (Bashkia Vore) | 790 | | Arsim parauniversitar | Bashkia Vorë | Bashkia Vorë | Ndërtesa shembur si pasoje e tërmetit me dt.26.11.2019 |
| | | | PF | Fshati Bërxullë | 5280 | | | | | Sip prej 5280m2 është terren sportive në funksion të shkollës |

